

Sot, më 01 / 09 / 2025

STATUTI

**I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
"4 M Studio" Sh.p.k.**

KAPITULLI I

EMRI, FORMA E SHOQËRISË, SELIA, OBJEKTI, KOHËZGJATJA

Neni 1

Themelimi

- 1.1 Emri i shoqërisë është **"4M Studio"** Sh.p.k (këtu më poshtë e quajtur **"Shoqëria"**). Shoqëria është themeluar në formën e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar në përputhje me legjislacionin shqiptar.
- 1.2 Shoqëria fiton personalitet juridik me regjistrimin në Qendrën Kombëtare të Biznesit ("**QKB**").
- 1.3 Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe Statutin.

Neni 2

Selia

- 2.1 Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën: "Rruga Liria; Zona kadastrale 1649, Numri i Pasurisë 41/14; 1054; Valias, Tiranë, Shqipëri".
- 2.2 Shoqëria mund të themelojë degë, filiale dhe/ose zyra përfaqësimi brenda territorit të Republikës së Shqipërisë dhe/ose në shtete të tjerë, në përputhje me ligjet e zbatueshme dhe Statutin.

Neni 3

Objekti

- 3.1 Objekti kryesor i Shoqërisë do të jetë:

Shoqëria do të ushtrojë aktivitet në fushën e projektimit, zbatimit, supervizimit, kolaudimit dhe konsulencës në arkitekturë, urbanistikë, ndërtim, mekanikë, hidraulikë, energjetikë, elektrike, rrugë dhe hekurudha, për të gjitha llojet e objekteve civile, industriale dhe të posaçme, përfshirë ato të mbrojtjes, të policisë së shtetit dhe të shërbimit informativ. Ajo do të zhvillojë gjithashtu konsulencë dhe studime në fushën gjeologjike, topografike, minerare, të hidrokarbureve, të energjive të rinovueshme, të trajtimit të ujit të pijshëm, të mbetjeve të ngurta dhe të ndotura, si dhe të vlerësimit të ndikimit në mjedis. Shoqëria do të ofrojë konsulencë për kolaudim dhe kontroll të automjeteve dhe pajisjeve të tyre, si edhe shërbime në fushën e eficiencës energjetike, auditimit dhe menaxhimit të energjisë.

Objekti i veprimtarisë përfshin importin, eksportin dhe tregtimin me shumicë e pakicë të mallrave të ndryshme, pjesëve të këmbimit për automjete, makinerive dhe pajisjeve industriale, bujqësore,

blegtorale dhe teknologjike të çdo lloji, si edhe ngritjen e laboratoreve dhe impianteve të ndryshme inxhinierike. Përfshihet importi, eksporti dhe tregtimi i vajrave lubrifikantë, i pajisjeve dhe sistemeve të ngrohjes, ventilimit dhe kondicionimit të ajrit, si edhe i pajisjeve elektro-shtëpiake. Gjithashtu, shoqëria do të zhvillojë shërbime riparimi dhe mirëmbajtjeje për automjete të çdo kapaciteti dhe pajisje për servisimin e tyre.

Shoqëria do të merret me mirëmbajtjen e sistemeve dhe impianteve teknologjike, mekanike dhe elektrike për përdorim civil, mjekësor, ushtarak dhe industrial, përfshirë sistemet hidraulike, ujesjellësit, sistemet e ventilimit, hidrosanitarët dhe shkarkimet, mbrojtjen ndaj zjarrit, trajtimin dhe shpërndarjen e ujit, prodhimin dhe shpërndarjen e ajrit dhe gazrave të ndryshëm teknikë për përdorim spitalor ose industrial. Ajo do të kryejë punime dhe rikonstruksione të ndryshme ndërtimore, instalime të sistemeve elektrike dhe elektronike, automatizimi dhe transmetimi të të dhënave, sistemeve të ndriçimit, vaditjes së fushave sportive, stadiumeve, pishinave, saunave dhe hidromasazheve.

Shoqëria do të kryejë transport mallrash brenda dhe jashtë vendit, si për nevojat e veta ashtu edhe për palë të treta. Përfshihet edhe ofrimi i shërbimeve të konsulencës në fushën e studimit të tregut, asistencës për kërkim fondesh, investimesh dhe kredish financiare, hartimit të planeve të biznesit dhe menaxhimit të projekteve gjatë zhvillimit dhe në etapat pasuese.

Shoqëria mund të kryejë çdo veprimtari tjetër të ligjshme të parashikuar nga legjislacioni në fuqi. Aktivitetet që kërkojnë leje, licenca apo autorizime përkatëse do të ushtrohen vetëm pasi të jenë marrë këto leje, licenca apo autorizime.

- 3.2 Objekti i Shoqërisë mund të ndryshohet me vendim të Asamblesë së Ortakëve të Shoqërisë.
- 3.3 Kryerja e aktiviteteve, për të cilat nevojiten lejet dhe/ose miratimet përkatëse, do të bëhet pas marrjes së këtyre lejeve dhe/ose miratimeve.

Neni 4

Kohëzgjatja

- 4.1 Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë për një periudhë të pacaktuar.

KAPITULLI II

KAPITALI THEMELTAR, KONTRIBUTET, KUOTAT

Neni 5

Kapitali Themeltar dhe Ortakët

- 5.1 Kapitali themeltar i Shoqërisë është 100.000 (njëqind mijë) lekë, i ndarë në 1 (një) kuotë.
- 5.2 Ortaku Themelues është:
 - 1. Z. Shpresim Neçi, atësia Kadri, shtetas Shqiptar, lindur në Kukës, Shqipëri më datë 29.06.1994, banues në adresën "Rruga Migjeni; Ndertesa 37, Hyrja 1, Kashar,

Yzberisht; 1050, Tiranë” mbajtës i letërnjoftimit me nr. personal J406290330, zotërues i 1 (një) kuote me vlerë 100.000 (njëqind mijë) lekë, që përfaqëson 100% të kapitalit të Shoqërisë.

- 5.3 Kapitali themeltar do të shlyhet plotësisht në para nga Ortaku i vetëm i Shoqërisë pas themelimit të Shoqërisë.
- 5.4 Përgjegjësia e Ortakut të vetëm të shoqërisë shtrihet deri në shumën e kontributit të tij në kapitalin themeltar.

KAPITULLI III

ORGANET DREJTUESE TË SHOQËRISË

Neni 6

Ortakët

- 6.1 Asambleja e ortakëve është organi më i lartë vendimmarrës i Shoqërisë.
- 6.2 Asambleja e ortakëve ka funksionet e mëposhtme:
- Përcakton politikat tregtare dhe ekonomike të Shoqërisë dhe mbikëqyr zbatimin e këtyre të fundit nga administratori/ët;
 - Emëron dhe shkarkon administratorin/ët;
 - Emëron dhe shkarkon ekspertin (ët) kontabël dhe/ose likuiduesin (t) e Shoqërisë;
 - Përcakton shpërblimin e administratorit/ëve, ekspertit/ëve kontabël dhe likuiduesit/ve;
 - Miraton pasqyrat financiare vjetore dhe raportet e ecurisë së veprimtarisë të përgatitura nga administratori/ët;
 - Merr vendim për ndryshimet e këtij Statuti;
 - Merr vendim për zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të Shoqërisë;
 - Merr vendim për shpërndarjen e fitimeve, dividendëve;
 - Merr vendim për ristrukturimin e Shoqërisë ose prishjen e saj;
 - Merr vendim për çdo çështje tjetër të parashikuar nga ligji.

Neni 7

Regjistri i Vendimeve

- 7.1 Të gjitha vendimet e marra nga Asambleja e Ortakëve do të regjistrohen në Regjistrin e Vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen. Regjistri i Vendimeve do të mbahet nga Shoqëria, dhe çdo regjistrim do të nënshkruhet nga administratori/ët.

Neni 8

Administratori

- 8.1 Shoqëria administrohet nga 1 (një) administrator, i emëruar nga Asambleja e Ortakëve.



8.2 Administratori i Shoqërisë është:

1. - Z. Shpresim Neçi, atësia Kadri, shtetas Shqiptar, lindur në Kukës, Shqipëri më datë 29.06.1994, banues ne adresën "Rruga Migjeni; Ndertesa 37, Hyrja 1, Kashar, Yzberisht; 1050, Tiranë" mbajtës i letërnjoftimit me nr. personal J406290330.

8.3 Mandati i administratorit është për një periudhë prej 5 (pesë) vitesh, i ripërtërishëm, dhe, nëse është rasti, vazhdon deri në vendimin e ardhshëm të Asamblesë së Ortakëve që do të marrë vendim në lidhje me rinovimin e mandatit të tij apo emërimin e administratorit të ri.

8.4 Shoqëria përfaqësohet ndaj të tretëve nga Administratori.

8.5 *Administratori i parë i Shoqërisë si më sipër autorizohet për të kryer regjistrimin fillestar të Shoqërisë pranë QKB nëpërmjet portalit e-albania, personalisht ose nëpërmjet palëve të treta të autorizuar prej tij.*

Neni 9

Kompetencat e Administratorit

- 9.1 Përveçse kur parashikohet ndryshe me vendimin përkatës të Asamblese së Ortakëve për emërimin e Administratorit, Administratori ka të drejtat dhe detyrimet e mëposhtme:
- Administron veprimtarinë e Shoqërisë duke zbatuar politikat tregtare dhe ekonomike të përcaktuara nga Asambleja e Ortakëve;
 - Përfaqësimin e Shoqërisë në marrëdhënie me çdo palë të tretë;
 - Marrjen e masave për hartimin dhe mbajtjen në mënyrën e duhur të pasqyrave financiare dhe të dokumenteve;
 - Përgatitjen dhe nënshkrimin e pasqyrave financiare vjetore dhe balanceve të konsoliduar, përgatitjen e raportit të ecursisë dhe dorëzimin e këtyre të fundit bashkë me propozimin përkatës për shpërndarjen e fitimeve të Ortakëve për miratim;
 - Krijimin e sistemit të paralajmërimit në lidhje me rrethanat, të cilat kërcënojnë veprimtarinë e Shoqërisë;
 - Dorëzimin në QKB të dokumenteve dhe të dhënave të Shoqërisë, përveç rasteve kur ligji parashikon ndryshe;
 - Raportimin tek Ortakët në lidhje me zbatimin e politikave tregtare të Shoqërisë dhe në lidhje me përmbushjen e transaksioneve të një rëndësie të veçantë për ecurinë e Shoqërisë;
 - Kryerjen e çdo detyre tjetër të parashikuar nga ligji ose nga ky Statut.
- 9.2 Administratori mund të autorizojë palë të treta që të përfaqësojë Shoqërinë dhe të nënshkruajë çdo dokument, kërkesë ose aplikim në emër dhe për llogari të Shoqërisë.
- 9.3 Administratori është përgjegjës ndaj Shoqërisë për çdo dëm të shkaktuar si pasojë e mospërmbushjes së detyrimeve të parashikuara nga dispozitat e këtij Statuti dhe legjislacioni në fuqi.



KAPITULLI IV
VITI FINANCIAR – SHPËRNDARJA E FITIMEVE

Neni 10
Viti Financiar

- 10.1 Viti financiar fillon më 1 Janar dhe përfundon më 31 Dhjetor të çdo viti kalendarik. Në përfundim të vitit kalendarik Administratori harton pasqyrat financiare të Shoqërisë në përputhje me ligjet në fuqi.
- 10.2 Përgjashtimisht, viti i parë financiar fillon me regjistrimin e Shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe përfundon më 31 Dhjetor 2024.

Neni 11
Shpërndarja e Fitimeve

- 11.1 Pas miratimit të pasqyrave financiare dhe në rast se janë realizuar fitime, Asambleja e Ortakëve vendos në lidhje me shpërndarjen ose jo të këtyre të fundit.

KAPITULLI V
DISPOZITA PËRFUNDIMTARE


Neni 12
Ligji i zbatueshëm

- 12.1 Për të gjitha çështjet që nuk parashikohen në këtë Statut do të zbatohen dispozitat përkatëse të legjislacionit shqiptar në lidhje me shoqëritë tregtare.

Neni 13
Të ndryshme

- 13.1 Ky Statut është nënshkruar në 3 (tre) kopje origjinale në shqip.

ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E ORTAKËVE
SHOQËRIA “4M Studio”

 Z. Shpresim NEÇI
